

Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Po të shihni ndonjë revistë ose gazetë ka të ngjarë t'ju zërë syri numra të shkruar si përqindje. Po të ndiqni ndonjë veprimtari sportive, ka të ngjarë t'ju zërë veshi statistika të paraqitura në trajtë përqindjesh. Përqindjet ndeshen kudo! Po çfarë janë përqindjet? Fjala *përqindje* do të thotë “*për çdo 100*”, prandaj një përqindje e tillë si 50% është njëlloj si thyesa $\frac{50}{100}$ ose $\frac{1}{2}$ ose numri dhjetor 0,50 (ose 0,5). Thyesat, numrat dhjetorë dhe përqindjet mund të përdoren njësoj për të paraqitur pjesët e një sasive të tëra.

Shpesh fjala përqindje përdoret në kuptimin e përqindjes së një sasive të caktuar. Për shembull, mund të thuhet “Vetëm 73% e votuesve të regjistruar morën pjesë në votime gjatë zgjedhjeve të fundit.” Pavarësisht nga madhësia e referuar, 100% e një madhësie gjithnjë do të thotë e gjithë madhësia, dhe 50% gjithnjë ka kuptimin gjysma e asaj madhësie. Sasia e treguar nga një përqindje e caktuar ndryshon sa herë ndryshon madhësia vetë. Për shembull, 50% e 10 qenve është 5 qen, por 50% e 100 qenve është 50 qen.

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Ka shumë shembujsh përqindjesh në jetën e përditshme që mund të diskutoni me nxënësin, gjatë kohës që po studiojmë këtë kapitull. Bie fjala, mund t'i kërkonti fëmijës t'ju ndihmojë

- të llogaritni bakshishin kur hani në restorant,
- të llogaritni çmimin e një artikulli që ofrohet me 25% ulje,
- të krahasoni çmimet e artikujve të ndryshëm që kanë çmime të ndryshme, me përqindje të ndryshme uljesh në raport me çmimin e rregullt, dhe
- të krahasoni normat e interesit në kartat e kreditit.